

Udhëzim Periudha e kalimit për menaxhimin e tokës

1. Njohja prapavepruese e menaxhimit të tokës në bujqësinë organike

Hyrje

'Njohje prapavepruese e menaxhimit të tokës' do të thotë njohja e menaxhimit të mëparshëm të tokës.

Baza ligjore

Ky udhëzim i referohet 'Miratimit prapaveprues të një periudhe të mëparshme menaxhimi' në kontekstin e Rregullores Europiane për bujqësinë organike, Rregullave Ekuivalente të Albinspekt lidhur me Rregulloren Europiane për bujqësinë organike si dhe Ligjit shqiptar nr 9199.

Kuadri ligjor mbi të cilën mbështetet ky miratim është:

- ✎ Rregullorja e BE-së EEC 834/2007 & Rregullat Ekuivalente të Albinspekt me reg. EEC 834/2007, Neni 17(1)(e),
- ✎ Rregullorja e BE-së EC 889/2008 Rregullat zbatuese & Rregullat Ekuivalente të Albinspekt me reg. 889/2008 Neni 36(2),
- ✎ Ligji 9199, Aneksi A, pika 1.

Procedura për njohjen prapavepruese

Në varësi të menaxhimit të mëparshëm, një pikë më e hershme në kohë, mund të njihet në mënyrë prapavepruese si fillimi i periudhës së kalimit. Normalisht fillimi i periudhës së kalimit llogaritet, në pikën më të hershme, kur operatori ka notifikuar aktivitetin e tij te autoriteti kompetent dhe kur e ka bërë njësinë e tij, subjekt të sistemit të kontrollit

Gjatë vendimmarrjes për certifikimin do të merret në konsideratë edhe menaxhimi i mëparshëm i tokës. Kur merret një vendim pozitiv, produktet mund të tregtohen me tregues që i referohen metodës së prodhimit organike, në një periudhë të shkurtuar kalimi. Albinspekt merr vendime për njohjen prapavepruese për shkurtimin e periudhës së kalimit për 12 muaj, 24 muaj dhe 36 muaj.

A. Për të aplikuar për njohjen retroaktive me Albinspekt, një operator duhet të:

- 📄 Aplikojë parimet organike, siç janë përshkruar në rregulloret përkatëse, pa asnjë përjashtim, gjatë të gjithë periudhës së kalimit.
- 📄 Plotësojë dhe dërgojë Formularin e aplikimit (5.1.007). Formulari i aplikimit (5.1.007) mund të shkarkohet nga www.albinspekt.com.
- 📄 Dokumenta shtesë të aplikimit

Të Domosdoshme:

- Një hartë e detajuar e zonës e cila duhet të tregojë: vendndodhjen e parcelës/ve nën skemën e kontrollit

- Dokumenti pronësisë ose kontrata e qerasë së parcelës.
- Shënimet e fermës (përdorimi i pesticideve, plehrave, etj nëse ka pasur përdorim të inuteve).
- Certifikime të mëparshme sipas standardeve të ndryshme.
- Prova të kënaqshme që tregojnë se produktet e palejuara në bujqësinë organike, nuk janë përdorur në parcelat për të cilat aplikohet, për të paktën tre vitet e kaluara (psh. një raport me shkrim ose vërtetim nga një autoritet profesional i pavarur, ose nga një autoritet kompetent).

B. Në rast dyshimesh për prezencë të inuteve të palejuara rezistente në tokë Albinspekt përpara marrjes së vendimit ndjek hapat si më poshtë:

- Merret një deklaratë nga një palë e tretë (autoritet lokal) mbi historikun e kultivimeve dhe përdorimin e inuteve të palejuara rezistente në tokë në 40 vietet e fundit
- Kryhen analiza të tokës

Kriteret sipas të cilave inspektori vendos mbi dyshimet për prezencë në tokë të inuteve të palejuara rezistente janë:

- Historia e parcelave (lloji i bimëve të kultivuara më parë, metoda e kultivimit, njohuritë lokale, rendimentet etj)
- Vendndodhja e parcelave (zona prodhimi intensiv/ekstensiv)
- Etj

Albinspekt nuk merr asnjë vendim pozitiv për njohjen prapavepruese të menaxhimit të parcelave me prezence inutesh të palejura rezistente në tokë.

C. Inspektori i Albinspekt do të vizitojë zonën përpara marrjes së vendimit dhe do të shkruajë një raport mbi vlerësimin në terren (evidenca të vegjetacionit, parcelat fqinje, kufizimet, intervista me fqinjët, etj, duhet të jenë pjesë e raportit).

Ky raport mund të shoqërohet nga dokumentacion fotografik dhe do të vendoset në dosjen e operatorit, së bashku me aplikimin për njohjen prapavepruese.

Në rast se kërkohet miratim për parcelat djerrë ose të papërdorura, para-inspektimi duhet të kryhet përpara se të punohet toka.

Në raste dyshimesh inspektori do të marrë kampione (psh kampione toke ose bime). Kosto e analizimit të kampionit do të mbulohet nga operatorit.

Çertifikuesi i Albinspekt, do të shqyrtojë dokumentet e aplikimit dhe raportin e inspektorit, dhe do të marrë vendimin për njohjen prapavepruese.

Albinspekt do ta trajtojë çdo aplikim duke i parë rast pas rasti. Për këtë arsye, operatori duhet të provojë qartësisht dhe korrektësisht të gjitha kërkesat e mësipërme.